



REKUP

PUBLIKA KOSOVA

25.02.2026

Njësi:
Un:
Organ:

01 451-5795/26

ent
est

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

NË MES TË

KOMUNËS KLINË

DHE

QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS

STREHIMORE PËR VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE



Ne përputhje me Nenin 17.1(k) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28), Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare Ligjin Nr. 08/L-209 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ;Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës Ligjin; Nr. 06/L-111 për Inspektimin Social dhe ne përputhje me Statutin e Komunës Klinës , u pajtuam për këtë : Memorandum të Mirëkuptimit (MM) për mbështetje financiare të (QMG) Qendrës për Mirëqenien e Gruas (strehimores për viktimat të dhunës në familje)

Memorandum i Mirëkuptimit (MM)

Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për strehimoren për periudhën janar- dhjetor 2026

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje lidhet në përputhje me:

Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili parasheh financimin e ofruesve të licencuar të shërbimeve sociale nga komunat;

Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, që obligon institucionet publike të sigurojnë mbrojtje, strehim dhe rehabilitim për viktimat;

Legjislacionin për vetëqeverisjen lokale dhe buxhetin komunal.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

- 1.Sigurimi i strehimit të sigurt dhe të përkohshëm për gratë dhe fëmijët viktimat të dhunës në familje të komunës së Klinës ;
- 2.Perkrahje në financimin e Strehimores e cila gjendet në Komunën e Pejës si ofrues i licencuar i shërbimeve sociale;
- 3.Forcimi i mekanizmave lokalë të mbrojtjes sociale.

Neni 3

Objekt i Marrëveshjes

Objekti përfshin ofrimin e këtyre shërbimeve:

- Strehim emergjent dhe afatshkurtër;
- Ushqim, medikamente, veshmbathje dhe nevoja bazë jetësore;
- Mbështetje psikosociale dhe këshillim;
- Mbrojtje dhe siguri për viktimat;
- Bashkëpunim për ri integrim social.



Neni 4

Detyrimet e Komunës

Komuna obligohet që:

- Të financojë shërbimet e ofruara nga Strehimorja duke u bazuar në planin vjetor financiar dhe operacional në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe planifikimit buxhetor vjetor;
- Të referojë rastet përmes Qendrës për Punë Sociale dhe mekanizmave tjerë kompetentë;
- Të monitorojë përdorimin e mjeteve publike, në përputhje me legjislacionin financiar;
- Të sigurojë koordinim institucional në nivel lokal.

Neni 5

Detyrimet e Strehimores

Strehimorja obligohet që:

- Të jetë e licencuar dhe e regjistruar si ofrues i shërbimeve sociale;
- Të ofrojë shërbime në përputhje me standardet minimale të përcaktuara me ligj;
- Të mbajë evidencë dhe dokumentacion për çdo rast;
- Të raportojë periodikisht te Komuna për: numrin e përfituesve, shërbimet e ofruara, shpenzimin e mjeteve financiare;
- Të pranojë inspektim social dhe financiar nga autoritetet kompetente.

Neni 6

Financimi

Komuna e Klinës obligohet ti ndaj mjete financiare për shërbimet e ofruara ndaj grave dhe fëmijëve të me shumën prej 4000.00 euro për vitin 2026. Për vitet tjera shuma mund të ndryshoj në varësi të mjeteve financiare të Komunës. Mjetet financiare përdoren ekskluzivisht për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë prej 3 vitesh, me mundësi vazhdimi pas vlerësimit të performancës dhe disponueshmërisë buxhetore.

Neni 8

Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave

Palët obligohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale të viktimave, në përputhje me ligjet në fuqi dhe standardet e mbrojtjes së fëmijës dhe viktimave të dhunës.

Neni 9

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje zgjidhet me mirëkuptim. Në rast të moszgjidhjes, zbatohet legjislacioni i Republikës së Kosovës.



Neni 10

Dispozita Përfundimtare

Kryetari i Komunës duhet të siguroj zbatimin e plote të këtij memorandumi të mirëkuptimit Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe hartohet në dy (2) kopje identike.

PËR KOMUNËN

Kryetari i Komunës Klinë
Z. Zenun Elezaj



PËR STREHIMOREN

Drejtore QMG Pejë
Ardita Ramizi Bala

Data: 23. 02. 2026